




**KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



PROCESVERBAL I/2026

I mbajtur me rastin e mbledhjes së I (parë) për vitin 2026 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 22.01.2026
Ora : 10:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

Të pranishëm tjerë:

z. Flamur Bytyçi
z. Enver Shabani
znj. Mimoza Bajraktari
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Laureta Tafaj
z. Dardan Berisha

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Zyra për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend Dite

1. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të Buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2026;

Kryesuesi-e hedhë në votim rendin e ditës

Unanimisht miratohet

Pika 1.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të Buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2026;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Laureta Tafaj-Përshendetje për të gjithë,bashkë me koleg të tjer Asambleist kemi ardhë në përfundim që këtë buxhet ne kemi me kundërshtu,ndryshimet që kan ndodhur për tre muaj nuk e di a jan teknike apo si jan përcaktu por besoj që sqarimet kemi me i marrë ndërkohë ama nuk është ba asnjë konsult paraprake me qytetarët të cilëve ja keni zvoglu buxhetin e disa fshatërave,janë disa projekte që nuk e dijmë a mundë të përfundohen ku para tre muaj ka qenë kosto tjetër për ndërtimin e atyre projekteve si psh në fshatin Bllacë,Budakovë etj jan të zvogluar po thuajse nga secili fshatë nga 10.000€ vetëm kisha dashtë një përgjigjje për këtë se si e keni parapa me i përfundu,a janë më lirë ndërtimet e rrugëve tash apo janë zvoglu parametrat?

Kryetari-nuk është vetëm fshati Bllacë apo Budakovë ka edhe fshatëra të tjerë që u është zvoglu buxheti përshkak që ka hy në buxhet edhe çerdhja e fëmijëve në fshatin Bllacë,ka hy shkolla në fshatin Njëpërbisht,objekti i zjarrëfiksave në Shirokë 250.000€ përshkak që donacion janë 600.000€ dhe kjo është arsyeja që jan hek në shumë fshate nga 10.000€ .

Laureta Tafaj-qfarë ka ndodh me ipiantin e Ujërave të zeza në fshatin Sllapuzhan?

Kryetari-impianti i ujërave të zeza në fshatin Sllapuzhan është ndërpre për shkak që nuk na kan leju me ndërtu objektin,përmbaruesi i ka marrë mjetet,nëse nuk gaboje 4,133,000 nuk na e kan dhënë pronën ,kemi pasë probleme me pronën vazhdojmë në fshatra tjerë.

Laureta Tafaj- a janë të njoftuar qytetarët që kan ndodhë ndryshimet? Paraprakisht ka pasë ndëgjime publike dhe tash që jan ndryshu ata nuk e dinë.

Kryetari-Jo nuk jan të njoftuar.

Laureta Tafaj-Si e arsyetojmë te qytetarët këtë?

Kryetari-ky buxhet është i ndam në bazë të numrit të banorëve,aq sa kemi buxhet do ti përfundojmë projektet sepse nuk kemi mundësi më shumë.

Laureta Tafaj-nëse ky buxhet kish qenë në përputhje me kërkesat kishim dashtë edhe ne me votu sepse dhe ne po dalim keq para qytetarëve kur po jemi kundër sepse ata nuk po e dinë që ky buxhet ja shumë gabime.

Sanie Kuçi Rexhepaj-fillimisht KPF-së i urojë një rrugëtim të mbar katër vjeçarë,një bashkëpunim të mirë me qëllim që pikat të diskutohen në këto takime tona të rregullta dhe me pasë pesh me u ndëgju,dhe Kryetar faleminderit që je prezentë sot,po ta them në këtë formë përshkak që kam qenë pjesë e KPF-së edhe në mandatin e kaluar mungesa juaj ka qenë e dukshme dhe po

të kërkojë që të jesh prezentë në secilën mbledhje të KPF-së përshkak se këtu roli jonë është që me u diskutu pikat para se me shku në Asamble,dhe qdo pyetje e jona mos me pasë veshë të shurdhër por me pas përgjigje nga ana e ekzekutivit,këtë kërkesë e kam edhe për Drejtorat e ardhëshëm që do të vin,në pikat kur janë të varura nga secila drejtori të paktën drejtori,apo një përfaqësues i asaj drejtorie me qenë prezentë në mbledhjet e KPF-së.Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës më faktin që Kryetari harton buxhetin unë po mendojë pak më ndryshe Kryesues përshkak që roli i KPF-së është shumë i madh gjatë hartimit të buxhetit,kshtu që shqetësimi im është neglizhimi i KPF-së gjatë ndryshimeve që janë bërë në buxhet,përshkak që drafti kryesor është i përpilum në mandatin e kalum dhe tash jemi në mandat komplet të ri dhe roli jonë tash ka fillu prej fillimit dhe është dashtë të paktën një mbledhje para KPF-së ashtu siq është edhe praktika me u diskutu dhe me u dhën propozimet nga anëtarët e KPF-së dhe KK-së ose shefat e grupëve qysh ka qenë praktika e zakonshme.Shqetësimi im është në këtë pikë që nuk e harton veq Kryetari e hartojnë qytetarët,duhet me u ndëgju kërkesat e tyre ,mos me u mbajtë ndëgjimet publike veq sa për sy e faqe sepse e kemi obligim ligjor por me u ndëgju kërkesat e tyre.Psh ura në fshatin Billacë është për fat të keqë në gjendje shumë të keqe dhe është rruga që të dërgon për te Shkolla,por ka edhe pika të tjera që ndoshta duhet me u rregullu,nuk po e minimizojmë ndoshta 25 ura sa i përmende të tjera mirpo po e theksojë nevojën e urave të tjera që janë të nevojshme.

Kryesuesi-nga praktikat e kaluar është mandati i tretë si Kryesues i Kuvendit,gjatë këtij mandati 8 vjeçarë minimumi 10 takime i kemi mbajtë sa herë që kemi pas planifikime të buxhetit ju kemi thirrë dhe ka pas raste kur keni dhënë propozime dhe përsëri nuk e keni votu dhe nga praktikat e kaluara nuk e kam pa të arsyeshme me ju thirrë në mbledhje para kësaj mbledhje,sikur të kishit reflektu në të kaluarën pa asnjë problem dhe jemi të gatshëm me bashkëpunu.

Laureta Tafaj-ka pasë raste kur ato projekte që i kemi propozu ne është shkru tekstaulisht dhe nuk ka hy në buxhet është reciproke.

Sanie Kuqi Rexhepaj-është hera e parë si Sanie që nuk e kam votu buxhetin ka qenë në Shtator të vitit të kaluar për arsye të vetme që kam qenë pjesë e një planprogrami 4 vjeçarë të një partie tjetër dhe ajo nuk ka qenë në përputhje planifikimi buxhetit,për mendimin tim planifikimi buxhetit në kohë fushate zgjedhore as nuk duhet me u bë përshkak që secila parti politike ka një program të vetin që don me zbatu dhe planifikon me qenë pjesë e asaj qeverie,kështu që ajo ka qenë qëllimi që unë në Shtator nuk e kam miratu.Arsyeja pse ndoshta kjo ndodhë ju e keni një barrë të fajit ndaj asaj që the në përgjithësi është fjala përshkak se nuk duhet me u dorëzu në bashkëpunim veq pse unë e propozova një projektë dhe ti e futë në buxhet dhe prap nuk e votova përshkak se e përmendi edhe Laureta,njëra prej rastëve ka qenë seanca e jashtëzakonshme që ka ndodhë në vitin 2024 jan qu Asambleistat kanë dhën propzime dhe janë bërë kishe po shënohen dhe nuk është marrë parasysh asnjë propozim i Asambleistave.

Kryesuesi-kemi pasë rastë kur jan mbajtë 36 ndëgjime publike dhe vetëm2-3 asambleistë që kan marrë pjesë,përderi sa na e kemi marrë një besim të qytetarëve ne e kemi për obligim me qenë për qytetarët në takime.Tu e pa të kalumen ne jemi për bashkëpunim dhe kur vjen qarkorja e parë për vitin 2027 vazhdojmë së bashku.

Sanie Kuqi Rexhepaj-një pyetje për zyrtarin ligjorë,A mundësh mema spjegu rolin e KPF-së gjtë hartimit të buxhetit? Nga ana profesionale.

Avni Bytyqi-përsëndetjë për të gjithë,siqë e parashehë edhe ligji për vetë qeverisje lokale, KPF është komunitet i cili e ka për obligim të merrë pjesë në procesin e hartimit të buxhetit,sa i përket diskutimeve publike në këtë fazë që jemi nuk e diskutum këtë çështje kjo procedurë ka përfunduar në fundë të muajit Gushtë me gjithë arteriet kryesorë të cilët kanë qenë kompetent për të diskutuar projekt buxhetin, ndërsa këto ndryshime që edhe unë i kam vërtetë dhe i kam pa që i ka ba Kryetari

i Komunës,dhe i ka ba mbi bazën e asaj që nuk e ka dëmtu asnjë projektë prej listës së investimeve kapitale apo nga buxheti i Komunës që e ka parapa në Shtator,mirpo vetëm ka shtu projekte si pasojë që kanë lindur mbas zgjedhjeve dhe ka hekë buxhet që nuk e ka dëmtu asnjë projekt dhe përgjegjësin e mbanë Komuna që në të ardhmën me i realizu këto projekte.

Flamur Bytyqi-përsëendetje për të gjithë,është hera e parë që jam pjesë e KPF-së,ashtu siq e tha edhe Avnia, po besojë që ne veq jemi kompetentë dhe ndoshta është dashtë me mbajtë një takim pak më të gjërë dhe me marrë miratimin tonë,unë tu e pa dokumentin dhe po besojë që ky dokumentë është ka përsëritet tana herët me gabimët e njëjta ku sherri i këtyre gabimëve shumë zyrtarë të Komunës tonë janë me aktakuzë përshkakë që janë këto ndryshime,njëra prej rastëve e kemi rrugën “ Halim Trolli” dhe” Osuni” në Gelancë,ka qenë “Osuni” është bërë “Halim Trolli”,kjo kornizë afatëmesme buxhetor duhet me u kthi në hapa për përmirësime,e keni rastin e dytë që ka gabime është në fshatin Semetishtë rrugën në të cilën ju e keni shënu ajo rrugë nuk egzistonë fare është në fshatin Shirokë,ky dokument përveq që nuk i përmbushë nevojat e qytetarëve por ka edhe gabime për të cilat unë nuk kam guxim me votu përshkak se edhe ne e kemi një përgjegjësi.Në Peqan te salla e sportit që tri vite pa e përfundu,ku më e rëndësishme dhe më e nevojshme për banorët është ujësjellësi me u bërë sepse ata kanë shumë probleme me ujë,dhe këtu tek rrugët që po shkruan segment ku është ai segment a mundëm me pa saktë ku është , a mundem me pa projektin,unë mendojë se,nëse ne e votojmë këtë buxhet shumë zyrtarë do ti rrezikojmë seriozishtë dhe kjo do të sjellë pasojë për ta.

Dardan Berisha-përsëendetje për të gjithë,nuk do të lëshohem në procedura ligjore besojë që procedurat ligjore ky buxhet i ka përfunduar në shtator të vitit kaluar,sa i përketë kërkesave të Asambleistave unë mendojë që kërkesat duhet me kan real,sepse secili nga ne që i kërkojmë nëpër fshatra tonë kërkesat janë personale sepse nuk është që ne e kemi komunikimin e jashtëzakonshëm edhe me qytetarët secili prej nesh e dijnë se si funksionon kjo qështje.Arsyeja pse ne nuk e kemi votu në Shtator ka qenë mungesë e disa rrethanave dhe mungesë e koncensusit,kjo ka qenë arsyeja e vetëme duke pas parasyshë që të gjitha kërkesat e grupit të asambleistëve të PDK janë në buxhetin që është këtu para nesh.Unë mendojë që qdo vonesë që ne sotë e bejmë sepse buxhetin nuk e ka votu edhe në shumë Komuna tjera,kjo është bërë praktikë që vitin e fundit nuk po e kalonë asnjë Komunë dhe qdo vonesë ndikon neegativishtë në zhvillimin e Komunës andaj unë jam pro e këtij buxheti.

Enver Shabani-përsëendetje për të gjithë,unë nuk kam ndonjë vërejtje për buxhetin por para se me ardhë në takim mora një mesazhë nga Shefi i grupit të Aleancës nga Azizi ai ka një kërkesë për disa ndryshime të disa rrugëve ose si plotësim me i shti nëse jo nga ne nuk ka vërejtje .

Kryesuesi -e hedhë në votim pikën 1

4 vota për 3 kundër 0 abstenim miratohet